Atij që shpik diçka në çështjen tonë, që nuk është prej saj, do t'i refuzohet

Nëna e besimtarëve, Umu Abdullah, Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!), transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Atij që shpik diçka në çështjen tonë, që nuk është prej saj, do t'i refuzohet." Në një transmetim të Muslimit, qëndron: "Atij që punon një vepër, jo sipas udhëzimit tonë, do t'i refuzohet."

[Sahih] [رواه البخاري ومسلم]

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se kushdo që shpik në fe ose bën diçka për të cilën nuk ka argument nga Kurani dhe Suneti, ajo do t'i refuzohet vepruesit të saj dhe do të jetë e papranueshme tek Allahu.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/66514